



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dekument Parlamentar)

Tiranë, më ____ . ____ 2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR RINOVIMIN E KONVIKTEVE NË KAMPUSIN UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFIÇENCËS ENERGJITIKE, FAZA III””

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e tij të datës 11 mars 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës”.

Relator i projektligjit është deputeti Ismet Beqiraj.

Në mbledhjen e Komisionit, gjatë diskutimit në parim, nen për nen dhe në tërësi ishin të pranishëm: zoti Ilir Bejtja, Zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; zoti Agim Bregasi, drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Elektroenergjitik dhe Efiçencës së Energjisë, si dhe zoti Ardian Islami, përgjegjës sektori në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në fushën e energjisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të nenit 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Projektligji është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave.

Ky projektligj nuk përafron me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Europian, është në përputhje të plotë me ligjin nr.116/2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, si dhe me ligjin nr.124/2015, “Për eficientësinë e energjisë”, të cilat transpozojnë pjesërisht direktivën 2012/27/BE dhe direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, mbi performancën energjitike të ndërtesave.

Diskutimi i projektligjit u realizua nga deputetët e shumicës.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1 Qëllimi i projektligjit:

Sipas relacionit shoqërues, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës”, sipas parimit të eficientësisë energjitike, Faza III”, ka për qëllim të mbështesë përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës universitare, konvikteve të studentëve, duke synuar kurse të ndjeshme të energjisë, kushte jetese të përshtatshme dhe kosto të arsyeshme akomodimi.

2.2 Risitë e projektligjit

Projektligji i propozuar nga Këshilli i Ministrave sjell risi si:

- Përmes ratifikimit të kësaj marrëveshjeje për rehabilitimin e konvikteve, synohen kurse të ndjeshme të energjisë dhe mundësohen kushte të përshtatshme jetese për studentët me kosto normale të akomodimit.
- Kjo marrëveshje sjell impakt pozitiv në mjedis, për shkak të reduktimit të emisioneve të karbonit/CO₂.
- Përmes financimit të projektit synohet ulja ndjeshëm e kostove që duhet të paguajë Bashkia Tiranë dhe Rezidenca Studentore Universitare nr.1 për ngrohje/ftohje dhe energji elektrike.
- Përmes saj synohet të krijohet një model ekonomik i caktuar, i cili mund të shërbejë si model për projekte të tjera publike.

Gjatë diskutimit në parim të projektligjit, deputetët vlerësuan përkushtimin e Qeverisë, edhe përmes kësaj marrëveshjeje, për zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura nga studentët, të shprehura në protestën e tyre, për një nga pikat: përmirësimin e infrastrukturës së konvikteve, Rehabilitimi i konvikteve të Tiranës është domosdoshmëri. Në varësi të buxhetit në dispozicion, projekti do të përfshijë rehabilitimin e konvikteve nr.3, 14, 16, 17 dhe 18, sipas përcaktimeve në marrëveshjet financiare, tashmë të dakordësuara me KfW, në lidhje me financimet në vlerat prej 4 500 000 eurosh (faza I) dhe 2 032 179.23 eurosh (faza II), si dhe, mundësisht, rehabilitimin e dy deri në katër godinave të tjera konviktesh.

Në secilin rast, para fillimit të punimeve për rehabilitimin me kushtet e eficientës së energjisë, fillimisht parashikohet të përcaktohet performanca energjitike aktuale e konvikteve, përmes kontrolleve të energjisë dhe auditimit energjistik të godinave etj..

Ky financim, përmes kësaj marrëveshjeje, i bashkohet qëllimit të programit për aplikimin e masave të eficientës së energjisë në godinat e konvikteve, me objektiva konkrete që kanë të bëjnë me auditimin energjistik të ndërtesave, për të identifikuar konsumin e energjisë aktuale dhe marrjen e masave për reduktimin e konsumit të energjisë; identifikimin e nevojave të rinovimit të ndërtesave; reduktimin e konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave, gjë që siguron dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve.

Me anë të kësaj marrëveshjeje, të dyja qeveritë bien dakord për akordimin e një granti nga qeveria gjermane, me vlerën deri në 2 927 765,96 euro, financim i cili do të vihet në dispozicion nëpërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW).

Deputetët vlerësuan kontributin në vijimësi të qeverisë gjermane në çdo fushë ndaj vendit tonë, si dhe grantin e ofruar nga ana e saj për financimin edhe të këtij projekti. Përmes kësaj marrëveshjeje, ata theksuan vizionin e qeverisë shqiptare për përmirësimin e jetës studentore, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme nga vendet e fuqishme europiane, siç është dhe në rastin konkret Gjermania.

Deputetët e shumicës në Komision janë besimplotë se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Bashkia e Tiranës me administratën e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1, Tiranë, do realizojnë me efektivitet rehabilitimin e këtyre godinave sipas standarteve europiane, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet e banimit të studentëve.

Në përfundim, pas diskutimit në parim, nen për nen dhe në tërësi, Komisioni me shumicë votash propozoi që ky projektligj të kalojë për miratim në seancë plenare.

RELATOR

Ismet BEQIRAJ

ZV/KRYETARE

Milva EKONOMI